



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2018:021796  
Datë: 16.04.2019  
Numri i dokumentit: 00280474

**P.nr. 1000/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtarin Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit Y. B. për shkak të dy veprave penale mashtrim nga neni 335 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale te vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së PTH –së në Pejë, PP/II.nr. 1880/2017, të dt.19.09.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të dt. 26.03.2019, në prezencë të Prokurorit te Shtetit Suada Hamza, të pandehurit Z.B. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit Xhelal Radoniqi mori dhe publikisht shpalli, ndera me dt. 15.04.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri

**Y. B., i biri i E. dhe nënës SH., e gjinisë Z., i lindur me dt. ..., identifikohet në bazë të lnj.nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme teknike, i pa punë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. tel. 044-408-174, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

- I. Me dt. 03.06.2017, rreth orës 19:30 minuta ne pompën e derivateve “S...”, me ane te paraqitjes se fakteve te rreme dhe me qellim te përfitimit te dobisë pasurore te

kundërligjshme për vete ose për ti shkaktuar dem material personit tjetër, e mashtron dhe me këtë e nxite personin tjetër që të kryej një veprim në dem të pasurisë së tij, në atë mënyrë që i pandehuri shkon në vendin e sipërshënuar, blen një glicerine, me një bankënotë prej 20 euro, ashtu që më pas punëtorit, të dëmtuarit-dëshmitarit H. B. ia kthen glicerinë, ndërsa ia merr prapë 20 euro si kusurin në vlerë prej 15 euro, e me pas largohet nga vendi i ngjarjes,

- me çka ka kryer veprë penale të mashtrimit nga neni 335 par.6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

**II.** Me dt. 17.06.2017, rreth orës 17:10 minuta, në popen e derivateve “K...” në Pejë, me ane të paraqitjes së fakteve të rreme dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete ose për ti shkaktuar dem material personit tjetër, e mashtron dhe me këtë e nxite personin tjetër që të kryej një veprim në dem të pasurisë së tij, në atë mënyrë që i pandehuri shkon në vendin e sipërshënuar, dhe nga i dëmtuari G.K. i cili aty punonte si kamarier, kërkon një mbushje telefoni prej 3 euro, e po ashtu edhe një pako cigare “Marlboro”, një picë si dhe nga dëshmitari – i dëmtuari G. merr 50 euro, me kërkesën se të gjitha do të paguaj deri sa të vije bashkëshortja e tij, e duke i premtuar edhe dhurate, ashtu që pasi e mashtron largohet nga vendi i ngjarjes,

- me çka ka kryer veprë penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPRK-së.

**III.** Me dt. 30.06.2017, rreth orës 03:40 minuta, në pompën e derivateve “S...” në Pejë, me dashje dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme, merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër, në atë mënyrë që i pandehuri shkon në vendin e sipërshënuar dhe pasi që e vëren të dëmtuarin – dëshmitarin H.B. se i njëjti ishte i habitur, i pandehuri nga kasa merr një qese me para të metalta në vlerë prej 120 euro, e me pas largohet nga vendi i ngjarjes pa u vërejtur nga askush,

-me çka ka kryer veprë penale të vjedhjes nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 41, 43, 46, 49 par. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, nenit 80, nenit 335 par.6 lidhur me par 1, nenit 325 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-se, të pandehurin e:

## **GJYKON**

I. Për veprën penale nga pika I, e dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej dy (2) muaj, ndërsa

II. Për veprën penale nga pika II, e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dënim me gjobe në shumën prej 100 (njëqind) euro dhe dënim burg në kohëzgjatje prej katër (4) muajve ,

III. Për veprën penale nga pika III, e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dënim me gjobe ne shumen prej 200 (dyqind) euro dhe dënim burg në kohëzgjatje prej shtatë (7) muajve ,

Andaj, konform nenit 80 të njëjtit i shqipton

### **DENIM UNIK me Gjobë dhe me Kusht**

-Dënim me gjobe ne shumen prej 300 (treqind) euro i cili dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj me se largu ne afat prej 60 ditësh, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit, dhe me

- Dënim me burg në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muajve, mirëpo ky dënim nuk do te ekzekutohet në rast se i pandehuri brenda periudhës një (1) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

-Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin nuk e paguan dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor ne shumen prej 50 (pesëdhjetë) €, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit H. B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP PP/II.nr. 1880/2017 kundër të pandehurit Y. B. për shkak të dy veprave penale mashtrim nga neni 335 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale te vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 26.03.2019, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe bazuar ne dispozitën e nenit 244 të KPP-së, është konstatuar se prokurori i shtetit, ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave.

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroj se i ka kuptuar këto të drejta.

Para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit bëri përmirësimin e dispozitivit të parë të aktakuzës sa i përket kualifikimit të veprës penale, pasi që dobia pasurore e përfituar nga i pandehuri është nën 50 euro ashtu që në rastin konkret bëri kualifikimi adekuat duke hequr kualifikimi paraprak sa i përket paragrafit 1, dhe në vend të paragrafit 1 duhet të jetë par. 6 e lidhur me par. 1, pasi që vlera e dëmit është nën 50 euro.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftua për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësie.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, pa presion nga askush. Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, i cili është pajtuar me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, nga se pranimi i fajësie është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën e veprës penale, ku pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat materiale të cilat prokurori ia ka bashkangjitur aktit akuzues.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që u bind se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti i policit Rasim Podrimqaku, deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit H.B. e dhënë me dt. 01.07.2017 ne Stacionin Policor ne Pejë, raporti i policit R.B., raporti i policit O. G., deklarata e te dëmtuarit –dëshmitarit G. K. e dhënë me dt. 18.06.2017 ne Stacionin Policor ne Pejë, raporti i policit E. L., si dhe deklarata e te pandehurit Y. B. e dhënë me dt. 30.07.2017 ne Stacionin Policor ne Pejë, si dhe shkresat e lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Y.B., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, mashtrimit, nga neni 335 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për te pandehurin, gjykata mori sjelljen korrekte në gjykatë, gjatë shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë, sinqeritetin deklarues, gjendja e tij e dobët ekonomike, pasojat e veprës penale dhe lartësinë e dëmit të shkaktuar palës se dëmtuar dhe shprehjen e gadishmëris për ti kompensuar palët e dëmtuara, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të

parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet për paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit i udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr. 1000/17 dt. 15.04.2019**

**Bashkëpunëtore Profesionale**  
Selvane Bukleta

**GJYQTARI**  
Shaqë Curri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate